



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2022, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR PRISHTINA INTERNATIONAL FILM FESTIVAL**

**I.**

**MIRATOHET** Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Prishtina International Film Festival, edicioni i 14-të, për aktivitetet me ODESA International Film Festival.

**II.**

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 23,000.00 (njëzet e tre mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve të Drejtorisë së Kulturës.

**III.**

Qëllimi i këtij Vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II për zhvillim të aktiviteteve të PRI FEST me ODESA IFF.

**IV.**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

**V.**

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-451/02-177449/22, më 26.07.2022

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Fehmi Kupina**

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë  
Telefon: + 381(0)38/230-900  
<http://www.prishtina-komuna.org>

